

**VENDIM**  
**Nr. 345, datë 23.9.2021**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME**  
**LIBRAZH-D-PËRRENJAS SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-ja nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 21.10.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Librazhd-Përrenjas sh.a.’”,

**VËREN SE:**

1. Ujësjellës-Kanalizime Librazhd-Përrenjas, me shkresën nr. prot. 179, datë 10.5.2021, me shkresën nr. prot. 401, datë 9.8.2021 dhe me shkresën nr. prot. 439, datë 10.9.2021 ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Librazhd-Përrenjas në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Librazhd-Përrenjas ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 21 181 banorë të Bashkisë Librazhd-Përrenjas;

b) drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Mirela Biba (Hoxholli), është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë, dega “Hidroteknikë”, në vitin 1993;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Librazhd-Përrenjas, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Librazhd–Përrenjas është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd–Përrenjas sh.a., me (NUIS J68122606V), në kategoritë:

- a) kategoria A – “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- b) kategoria C – “Për largimin e ujërave të ndotura”.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd–Përrenjas sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) drejtues ligjor – Agron Gega;
- b) drejtues teknik – Mirela Biba (Hoxholli).

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd–Përrenjas sh.a. është Bashkia Librazhd–Përrenjas.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd–Përrenjas sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd–Përrenjas sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Ndriçim Shani**